



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË**

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 28.01.2020 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJ

Në mbështetje të nenit 55 dhe nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 29.05.2026 “Për transferimin e administrimit dhe veprimtarisë së Sektorit “Eco Kolonja”, Qendrës Kulturore “Fan Noli” dhe Klubit Sportiv “Gramozi” pranë shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., si dhe për mbylljen e NIPT-eve përkatëse”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli I Bashkisë Kolonjë në mbledhjen e tij date 09.07.2026

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë Vendimin nr. 13, datë 28.01.2020 “Për krijimin e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe shpërblimin e anëtarëve të tij”
2. Pagesa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Artistiko-Kulturor për periudhën Janar–Qershor 2026, si dhe detyrimet përkatëse të tatimit në burim, të përballohen nga shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a., në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 71, datë 29.05.2026.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Drejtoria e Financës dhe shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a., sipas fushave të përgjegjësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura .
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Artit, Kultures dhe Sportit dhe shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a., sipas fushave të përgjegjësisë

**KRYETARI I BASHKISË
ERION ISAI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI I BASHKISË

RELACION PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. Datë /01/ 2026

“PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 13, DATË 28.01.2020 “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË TIJTË NDERUAR!

Këshilli Artistiko-Kulturor, i krijuar me Vendimin nr. 13, datë 28.01.2020, ishte ngritur për të mbështetur funksionimin e Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit, duke shqyrtuar dhe vlerësuar projektet artistike e kulturore që financoheshin nga Bashkia Kolonjë.

Me transferimin e administrimit dhe veprimtarisë së Qendrës Kulturore “Fan Noli” pranë shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., organizimi institucional dhe funksional i veprimtarive kulturore është rikonfiguruar, duke bërë të nevojshëm rishikimin e akteve administrative që lidhen me strukturat e ngritura sipas organizimit të mëparshëm.

Për këtë arsye propozohet shfuqizimi i Vendimit nr. 13, datë 28.01.2020.

Gjithashtu, për të garantuar përmbushjen e detyrimeve financiare të krijuara për periudhën janar–qershor 2026, në projektvendim parashikohet që pagesa e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Artistiko-Kulturor, si dhe detyrimet përkatëse të tatimit në burim, të përballohen nga shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a., në përputhje me transferimin e administrimit dhe veprimtarisë të miratuar me Vendimin nr. 71, datë 29.05.2026.

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Artit, Kultures dhe Sportit dhe shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a., sipas fushave të përgjegjësisë.

PUNOI:Eni Duro

KONFIRMOI: Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO